

MINUTAT E KOMITETIT TË MONITORIMIT IPARD II

Minutat nr. 4

Minutat e takimit të katërt të Komitetit të Monitorimit të IPARD II

19 Mars 2019, Tiranë (Shqipëri)

I. Lista e pjesmarrësve:

Në takim morën pjesë antarët e Komitetit Monitorues të IPARD II (në vazhdim: KM), përfaqësues të Komisionit Evropian dhe të Delegacionit Evropian në Tiranë (shih listën e pjesmarrësve në Annex 1).

Rezultati: ishin prezentë 23 anëtarë/zëvendësues nga 29 anëtarë me të drejtë vote. Kuorumi është arritur dhe vendimet mund të merren (shih Aneks 1).

ANEKS 1: Lista e pjesmarrësve

ANEKS 2: Axhenda e takimit të Komitetit të Monitorimit

ANEKS 3: Fjala e Ministrit, z. Bledar Çuçi

ANEKS 4: Prezantim i **Z. Liam Breslin, Shef i Njësisë së Ndhmës për Para-Anëtarësim, DG AGRI, Komisioni Evropian.**

II. Axhenda

Moderator Z. Grigor Gjeçi – Drejtues i Autoritetit Menaxhues të IPARD

1. Fjala e mirëseardhjes dhe hapja e takimit nga z. Bledar Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
2. Fjalë e mbajtur nga Z. Liam Breslin - Shef i Njësisë IPARD, DG-AGRI;
3. Aprovimi i Axhendës;
4. Miratimi i minutave të takimit të 3-të të Komitetit të Monitorimit IPARD II (21.03.2018);
5. Implementimi i programit IPARD II:
 - Informacion mbi dhënien e besimit të IPARD II (masat, rekomandimet) (Z. Erjon Luçi, Zëvendës Ministër i Financave- ZKA)
 - Informacion mbi fushatën e publicitetit për thirrjen e parë për aplikime, monitorimi në vazhdim (AM);
 - Informacion në lidhje me rezultatet e aplikimit në thirrjen e parë dhe progresin e vlerësimit. (AZHBR);
 - Diskutim mbi modifikimin e tretë të programit IPARD II (MA);
 - Diskutim mbi modifikimin e dytë të listës së shpenzimeve të pranueshme (AM);

- Informacion mbi thirrjet për aplikimet në vitin 2019 (AM);
 - Informacion mbi parashikimin për akreditimin e masave (AM).
6. Prezantimi nga DG- AGRI për Politikën CAP/PPB pas vitit 2020;
 7. Propozimet për datën dhe axhendën e takimit të radhës së KM;
 8. Mbyllja e takimit.

III. Rezultati i takimit të Komitetit të Monitorimit të IPARD II

Hapja e takimit dhe fjalimi i mirëseardhjes nga Z. Bledar Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Z. Ministër, Bledar Çuçi: përshëndeti dhe i uroi mirëseardhjen në takim **Z. Liam Breslin** dhe përfaqësuesve të tjerë të KE, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë, anëtarëve të KM, si edhe të ftuarve të tjerë. Ai theksoi që takimi i KM nuk duhet të konsiderohet si një takim rutinë pune, por si një moment shumë i rëndësishëm për të riafirmuar edhe njëherë përkushtimin maksimal për të çuar përpara programin IPARD, si një mundësi e artë për mbështetjen e sektorit bujqësor dhe atë rural.

Po kështu zoti Ministër përmendi suksesin e thirrjes së parë me 317 aplikimeve dhe buxhetit prej 56 mln Euro. Në fjalën e tij ai u shpreh se një nga nismat e tij të para si Ministër i Bujqësisë ishte sigurimi dhe koordinimi i duhur dhe i shpejtë i punës së institucioneve për marrjen e dokumentave që nevojiten për aplikime me fondet e IPARD. Një nga detyrat afatshkurtra për strukturat e IPARD ka të bëjë me realizimin e sasisë së fondeve prej 7.2 milionë Euro deri në fund të vitit 2019.

Nga ana tjetër ai vlerësoi mbështetjen që ekipi i DG- AGRI ka shprehur për të miratuar propozimin mbi ngritjen e pragut për SME-të në 12 milionë euro si dhe premtoi se do të vazhdojë të jetë i përkushtuar për të adresuar si duhet të gjitha nevojat e Agjencisë IPARD dhe të Autoritetit Menaxhues në mënyrë që programi të zbatohet në mënyrë të suksesshme. Gjithashtu ai theksoi se po bëhen përpjekje edhe për të rritur numrin e stafit në Agjencinë IPARD.

Sa i përket akreditimit të masave të reja, do të bëhen të gjitha përpjekjet për finalizimin dhe dërgimin e dosjes së Masës së Asistencës Teknike si dhe më pas të Masës “Agro-mjedisi, klima dhe bujqësia organike”; “Qasja LEADER” dhe “Shërbimi Këshillimor”.

Në përfundim, **Z. Ministër, Bledar Çuçi**, i siguroi edhe një herë pjesëmarrësit e KM për angazhimin e Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Bujqësisë për zbatimin e suksesshëm të këtij programi.

Z. Liam Breslin falenderoi Ministrin për fjalët e mira dhe pjesëmarrësit për prezencën e tyre në këtë takim. Ai falenderoi të gjithë autoritetet kombëtare përgjegjëse për aftësinë e tyre për të marrë besimin dhe për të mobilizuar burimet e veta me qëllim realizimin e thirrjes së parë. 317 kërkesa të paraqitura dhe më shumë se 56 milionë euro të kërkuara nga IPARD II, tregojnë kërkesën e lartë dhe nevojat për investime në potencialin e zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale të Shqipërisë dhe mundësitë që ofron IPARD-i në të ardhmen e afërt.

Z. Liam Breslin shpresoi në vlerësimin dhe kontraktimin sa më të shpejtë të projekteve të suksesshme, me qëllim disbursimin e fondeve të IPARD si dhe shmangien e mos disbursimit të fondeve. Gjithashtu kjo është e rëndësishme pasi tashmë jemi edhe në fazën e programimit të programeve të reja.

Sa i përket zbatimit të IPARD, **Z. Liam Breslin**, theksoi rëndësinë e punës lidhur me përafrimin dhe përmbushjen e standardeve të BE-së në fushat e mbështetura nga IPARD. Në këtë drejtim, është me rëndësi të kemi bashkëpunim të fortë ndërmjet të gjitha autoriteteve përgjegjëse dhe trupave teknike, si shërbimi veterinar dhe inspektimi i ushqimit, së bashku me funksionimin e një regjistri kombëtar të fermës.

Z. Liam Breslin theksoi se IPARD mund të shërbejë si një instrument i rëndësishëm në përshpejtimin e hyrjes së Shqipërisë në BE gjatë dekadës së ardhshme nëse ky program do të zbatohet me sukses.

Ai kërkoi gjithashtu të përshpejtohet procesi i dorëzimit të masave të tjera për marrjen e besimit, duke nisur fillimisht me masën e Asistencës Teknike, për të cilën ka patur vonesa. Kjo masë do të lehtësonte ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe do të përmirësonte funksionimin e autoriteteve të përfshira në kryerjen e përgjegjësive të besuara për këtë proces.

Ai theksoi se imazhi i mirë dhe popullariteti i financimit përmes IPARD duhet të sigurohet gjatë gjithë procesit të zbatimit të tij. Është e rëndësishme të sigurohet një shpërndarje sa më e madhe e informacionit për aplikantët. Kjo vlen edhe për dhënien e informacionin në kohë për thirrjet dhe planet e mëtejshme për marrjen e besimit edhe për masat e tjera.

Z. Liam Breslin prezantoi **Z. Razvan Ghitescu**, i cili është pjesë e Delegacionit të BE-së që nga Shkurti 2019 dhe monitoron zbatimin e IPARD në vend. Ai vjen nga strukturat e DG-NEAR dhe ka një përvojë shumë të mirë në fushën e asistencës së para- anëtarësimit.

Z. Liam Breslin ftoi autoritetet kombëtare për të vënë në zbatim njohuritë dhe përvojën e tij në çështjet që lidhen me zbatimin e IPARD.

Ai mbylli fjalimin e tij të hapjes duke kujtuar se ka shpresa që lidhen me mbledhjen e Këshillit në qershor, gjatë së cilës mund të miratohen vendime për fillimin e negociatave me Shqipërinë.

Z. Grigor Gjeçi, shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e deritanishme të dhënë nga DG-AGRI lidhur me procesin e zgjerimit për tre masat kyçe dhe premtoi se të gjitha strukturat e përfshira në IPARD do të vazhdojnë përpjekjet për marrjen e besimit për masën e Asistencës Teknike dhe masat e tjera.

Z. Razvan Ghitescu bëri disa vërejtje në fjalën tij hapëse në emër të Delegacionit të BE-së në Shqipëri. Ai kujtoi se ky vit është një vit i rëndësishëm për bujqësinë shqiptare, pasi procesi i screening është planifikuar të fillojë, duke krijuar kështu kuadrin bazë të bisedimeve të ardhshme të pranimit në BE.

Ai vlerësoi rëndësinë e vitit 2018, si viti kur u dha besimi për zbatimin e IPARD dhe filloi thirrja e parë për projekte. **Z. Razvan Ghitescu** theksoi rëndësinë e forcimit të mëtijshëm të autoriteteve kombëtare të IPARD, e cila gjithashtu përfshin përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira me qëllim të shpërndarjes më të mirë të shpenzimeve dhe financimit nën IPA dhe IPARD.

Z. Razvan Ghitescu rikonfirmoi angazhimin e Delegacionit të BE-së për të ofruar çdo mbështetje të nevojshme për autoritetet.

Në përfundim të fjalimit të tij ai falenderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe i uroi sukses në punën e tyre në zbatimin me sukses të Programit IPARD II.

Z. Grigor Gjeçi përshëndeti **Z. Razvan Ghitescu** si pjesë e ekipit IPARD, duke theksuar se të gjitha sfidat dhe sukseset do t'i ndajmë më tej së bashku.

Miratimi i rendit të ditës dhe Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit të Monitorimit IPARD II të mbajtur më 21.03.2018

Sipas axhendës **Z. Grigor Gjeçi**, pyeti nëse anëtarët e KM paraqesin ndonjë ndryshim në Axhendën dhe procesverbalin e mbledhjes së mëparshme të KM. Duke pasur parasysh mungesën e ndonjë propozimi u morën vendimet e mëposhtme:

Vendim Nr. 1

Axhenda u miratua me konsensus.

Vendim Nr. 2

Mínutat e Takimit të tretë të KM u miratuan me konsensus.

Implementimi i Programit IPARD II

Z. Erjon Luçi theksoi se takimi i Komitetit të Monitorimit po zhvillohet në një kohë shumë të rëndësishme pasi dhe projektet e dorëzuara nën thirrjen e parë për aplikime janë duke u vlerësuar dhe shumë shpejt do të fillojë thirrja e dytë për aplikim.

Nga ana tjetër, ai vlerësoi se procesi ka ecur mirë deri më tani, por me disa pengesa, pasi duhen plotësuar disa elementë, përfshirë edhe përgatitjen e dosjes së Asistencës Teknike, e cila shumë shpejt do të jetë pranë DG – AGRI.

Ai e mbylli fjalimin e tij duke falënderuar të gjithë partnerët që kanë kontribuar në zbatimin e marrjes së besimit të IPARD.

Informacion në lidhje me fushatën e publicitetit për thirrjen e parë për aplikime, monitorimi në vazhdim.

Prezantimi u krye nga Znj. Anjeza Mezini, Përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit të IPARD të Autoritetit Menaxhues.

Ajo përmendi se Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD kanë përgatitur dokumentet e nevojshme të tilla si procedurat e tenderimit për spotte televizive dhe radio; kanë përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak; kanë përgatitur planin për fushatën e informimit; kanë publikuar udhëzuesin për aplikantët; kanë përgatitur planin e veprimit për thirrjen e parë si dhe kanë përgatitur minutat e takimit dhe pyetjet kryesore të ngritura gjatë eventeve. Ajo përmendi dhe situatën e takimeve rajonale dhe konferencën kombëtare të realizuar, ku numri total i pjesëmarrësve ishte rreth 1200 vetë dhe u përdorën rreth 256 pyetësorë.

Për Masën 1, ishin 65 pjesëmarrës të interesuar për sektorin e frutave dhe perimeve, 50 pjesëmarrës të interesuar në sektorin e qumështit dhe 33 pjesëmarrës në sektorin e mishit.

Për Masën 3, ishin 32 pjesëmarrës të interesuar për përpunimin e frutave dhe perimeve dhe për Masën 7, ishin 30 pjesëmarrës të interesuar për prodhimin e BAM-ve, kërpudhave, mjaltit, etj.,

Për Masën 7, ishin 30 pjesëmarrës të interesuar për prodhimin e BAM-ve, kërpudhave, mjaltit, etj., 30 pjesëmarrës të interesuar për përpunimin dhe tregtimin e BAM-ve të egra ose të kultivuara, 27 pjesëmarrës të interesuar për natyrën në masën natyra dhe turizmi rural.

Ndërsa në pyetësorët për nivelin e njohurive për IPARD II, 81 pjesëmarrës kishin mjaftueshëm njohuri dhe 63 pjesëmarrës prej tyre ishin të mirë informuar. Mënyra e preferuar për të marrë informacion për thirrjet ishin, 119 pjesëmarrës të interesuar për ditë informimi dhe seminare dhe 113 pjesëmarrës për publikime në internet.

Z. Zigo Rutkovskis përgëzoi autoritetet e IPARD për përpjekjet që kanë bërë për kryerjen e fushatës në një kohë të shkurtër pas marrjes së besimit për shkak të afateve të ngushta kohore. Ai vuri në dukje që numri i aplikimeve provoi që fushata ka qenë efektive, por ka ende nevojë për përmirësime, prandaj dhe fushata për thirrjen e dytë do të jetë më e madhe krahasuar me thirrjen e parë për aplikime.

Informacion në lidhje me rezultatet e aplikimit në thirrjen e parë dhe progresin e vlerësimit (AZHBR) fjalën e mori Zj. Frida Krifca, Drejtore e Agjencisë së Pagesave, e cila bëri një panoramë të përgjithshme për ecurinë e deritanishme të procesit të aplikimeve.

Ajo përmendi që për thirrjen e parë të IPARD, janë bërë 317 aplikime, ndërkohë që Analiza e Ngarkesës së Punës ishte llogaritur për 150 aplikime të mundshme.

Janë bërë 189 aplikime për masën 1 nga të cilat 150 për sektorin e Fruta Perimeve, 8 për sektorin e mishit, 17 për sektorin e qumështit dhe 14 për vresharinë.

Për masën 3 janë bërë 64 aplikime nga të cilat 30 në sektorin e fruta perimeve, 18 në sektorin e mishit, 6 në sektorin e qumështit dhe 10 në sektorin e Verës.

Për masën 7 janë bërë 64 aplikime.

Për mangësi të mëdha janë skualifikuar 44 aplikime. Në përgjigje të pyetjes së ngritur nga Z. Breslin lidhur me afatin e nënshkrimit të kontratave për secilën masë, ajo u përgjigj se procesi I nënshkrimit të kontratave do të fillojë në prill dhe do të zgjasë deri në qershor ose korrik.

Diskutim në lidhje me modifikimin e tretë të Programit IPARD II (MA)

Përsa i takon modifikimit të Programit IPARD, nga **Z. Grigor Gjeçi** u shpjegua se është menduar të ndërhyhet për 3 modifikime:

- Në përputhje me tavanin e SME-ve në ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (ligji në fuqi më 1 janar 2019), përcaktohet se taveni për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është 12 milionë euro. Prandaj, është e nevojshme të ndryshohet pragu për NVM-të sipas masave 3 dhe 7 të Programit;
- Sa i përket thertoreve, propozimi do të ishte heqja e kufizimit për të lejuar ndërtimin e dy thertoreve për rajonin NUTS II;
- Lidhur me pranueshmërinë e kooperativave nën masën 3, diskutimi është në proces me Agjencinë IPARD.

Z. Agim Rrapaj, Drejtor Ekzekutiv i KASH, konsideroi si problem shqetësues faktin se, disa ferma janë përjashtuar nga IPARD II duke pasur probleme me certifikatat e pronësisë. Kemi vështirësi, vazhdoi ai, pasi ka shumë zona që nuk mund të aplikojnë dhe se kemi shumë ferma që kanë sipërfaqe 0.5 Ha. Ai pyeti nëse mund ta rrisim më shumë nr. e Ha si dhe theksoi se në lidhje me stallat, pjesa më e madhe **s'kanë certifikata pronësie** dhe përjashtohen automatikisht nga IPARD II.

Nga ana tjetër, ai përmendi se në mënyrë që fermerëve t'u jepen makineri teknike u duhen këto certifikata dhe propozoi mundësinë e rishikimit të këtij kriteri.

Në lidhje me fjalën e **Z. Agim Rrapaj,** pati një ndërhyrje nga **Z. Erjon Luçi,** i cili shtoi se problematika ka të bëjë me ligjin shqiptar, ose është çështje e vendit tonë dhe s'ka lidhje me programin direkt. Sipërfaqja 0.5 Ha është për tokën e mbjellë, por duhet përsëri të shtoni hektarët. Ai premtoi se kjo çështje do të diskutohet dhe për këtë nxiti pjesëmarrësit të sjellin sugjerimet dhe argumentat e duhura për zgjidhje.

Z. Zigo Rutkovskis ndërhyri dhe falënderoi për këtë propozim i cili gjithashtu i dërgohet Komisionit. Ai vuri në dukje se, në përgjithësi, ka një mbështetje nga DG- AGRI për të rritur tavanin për SME-të, ndërsa propozimi në lidhje me thertoret duhet të përpunohet sërish. Ai theksoi rëndësinë që t'i paraqesë Komisionit ndryshimin e plotë të përgatitur si rezultat i diskutimeve midis autoriteteve kombëtare të IPARD dhe pas miratimit të modifikimit nga

KM nëpërmjet konsultimeve me shkrim. **Z. Zigo Rutkovskis** ftoi autoritetet kombëtare të punojnë ngushtë së bashku gjatë përgatitjes së modifikimit.

Z. Grigor Gjeçi, informoi se ndryshimi lidhur me thertoret mbetet një nga disa çështje, pasi vetëm 6 thertore mund të mbështeten sipas Programit që është aktualisht në fuqi. Zgjidhja do të kërkohej së bashku me DG- AGRI.

Diskutim mbi modifikimin e dytë të Listës së Shpenzimeve të Pranueshme (AM)

Në lidhje me modifikimin e Listës së Shpenzimeve të Pranueshme (LEE), **Z. Grigor Gjeçi** informoi se modifikimi kërkohej për të shmangur gabimet e vogla të identifikuar në lidhje me traktorët në vreshtari në LEE për Masën 1. Modifikimi do të korrigjojë mospërputhjet e identifikuar ndërmjet Programit dhe Listës së Shpenzimeve të Pranueshme. Për shembull, ndërtimi / rindërtimi i bujtinave do të lejohet "në zonë rurale" në vend të shprehjes "në fermë" siç është shkruar tani në LEE.

Fjalën e mori **Znj. Frida Krifca**, e cila theksoi se në lidhje me thirrjen e dytë, e cila do hapet në fillim të Korrikut, do të ketë një buxhet prej 50 milion EURO, kjo në varësi të rezultateve të thirrjes së parë. Në thirrjen e dytë do përfshihen të njëjtat masa bazuar në përvojën e së parës, kriteret dhe bashkëpunimin me Autoritetin Menaxhues dhe shërbimin këshillimor. Gjithashtu thirrja do të publikohet në faqet web. Në Qershor mund të fillojë fushata informuese.

Z. Liam Breslin mori fjalën duke vlerësuar se hapja e thirrjes së dytë në Korrik deri në Shtator është shenjë e mirë, por ai pyeti se çfarë do të ndryshohet si rezultat i përvojës së fituar pas thirrjes së parë.

Zj. Frida Krifca, u përgjigj duke treguar nevojën për dallimin në lidhje me bimët mjeksore dhe aromatike, ndërmjet masës 3 dhe masës 7. Ajo gjithashtu përmendi edhe çështjen kryesore që lidhet me mbështetjen e thertoreve.

Z. Liam Breslin pyeti për qasjen e përdorur në rastin e aplikimeve të paplota dhe atyre që mund të refuzohen ose të përjashtohen.

Zj. Frida Krifca, informoi se janë përjashtuar disa aplikime për mungesë dokumentacioni, por mund të përjashtohen edhe të tjera që mund të mos plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe ruhet e drejta për t'u kërkuar dokumenta shtesë. Ajo konfirmoi se në asnjë rast nuk do ndërmerren vendime pa patur siguri të plotë. E gjithë kjo do t'i paraprijë faktit që të mos tregojmë mangësi dhe të mos shpërdorjmë fondet.

Z. Liam Breslin pasi falënderoi **Zj. Frida Krifca**, u shpreh se ky është qëllimi dhe sigurisht shpreson që të mos ketë probleme në zbatimin e IPARD-it.

Në lidhje me thirrjet që duhet të parashikohen në të ardhmen, ai theksoi rëndësinë e përgatitjes së planit të parashikimit për vitin 2020, i cili duhet të publikohet jo më së vonë se dhjetori i çdo viti.

Parashikimi do të lehtësonte në përgatitjen më të mirë të përfituesve për thirrjet e planifikuara dhe do të zvogëlonte numrin e problemeve potenciale. Gjithashtu kjo do të lehtësonte punën për autoritetet kombëtare të përfshira, pasi numri i aplikimeve jo të plota ose me cilësi të ulët do të jetë më i ulët.

Z. Grigor Gjeçi pohoi se pati vonesa në parashikimin e procesit të publikimit për shkak të përgatitjes për thirrjen e parë. Ai konfirmoi se në bashkëpunim me Agjencinë IPARD plani për thirrjen e ardhshme do të përgatitet më parë paraprakisht dhe më pas do të publikohet në faqet e internetit të IPARD.

Vendim Nr. 3

Autoritetet kombëtare të IPARD do të vazhdojnë punën për modifikimin e tretë të Programit IPARD II dhe modifikimin e Listës së Shpenzimeve të Lejueshme (LEE).

Informacion mbi thirrjet për aplikime për vitin 2019 (AM)

Fjalën mbi thirrjet për aplikime për vitin 2019 e mori, **Zj. Violeta Bakalli, specialiste e Programimit IPARD**, e cila theksoi se sa i përket thirrjes së dytë të Programit IPARD në bashkëpunim me Agjencinë e Pagesave dhe bazuar në eksperiencën e fituar edhe nga thirrja e parë e Programit IPARD, është menduar që kjo thirrje të realizohet në periudhën 15 Korrik deri 15 Shtator 2019, me një buxhet rreth 50 milion Euro për të tre masat.

Ajo përmendi se fushata për thirrjen e dytë mendohet të bëhet rreth muajit qershor 2019 dhe do të paraprihet me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm.

Vendim Nr. 4

Thirrja e dytë për aplikim do të fillojë për tre masat M 1, M 3 dhe M 7.

Informacion mbi parashikimin për akreditimin e masave (AM)

Z. Grigor Gjeçi informoi se propozimi për dhënie të besimit për masat reja siç janë Infrastruktura Publike Rurale, Bujqësia Organike, Shërbimi Këshillimor dhe LEADER do të paraqitet në takimin tjetër të KM së bashku me modifikimin e Programit. Prezantimi i masave të reja do të kërkojë rialokime financiare ndërmjet masave.

Prezantimi mbi Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE pas vitit 2020:

Prezantimi u bë nga **Z. Liam Breslin**, i cili paraqiti në mënyrë të detajuar Politikën e Përbashkët të BE, ku kryesisht u përqëndrua në disa objektiva, prioritete dhe buxhetin

përkatës për zbatimin e kësaj politike dhe me një buxhet shumëvjeçar prej 1279.4 miliardë Euro, ku 442 miliardë shkojnë për inovacionin, dixhitalizimin, kohezionin dhe vlerat.

Ndër prioritetet kryesore, **Z. Liam Breslin** përmendi disa prej tyre si: inovacionin për bujqësinë; aftësinë ripërtëritëse të bujqësisë evropiane; fuqizimi i veprimit mjedisor dhe klimatik; krijimi i vendeve të punës në zonat rurale; përgjigja ndaj shqetësimeve të qytetarëve për një prodhim bujqësor sa më të qëndrueshëm, etj.

Po kështu, në prezantimin e tij u parashtruan edhe objektivat bazë, të cilat janë: rritja e konkurrencës; ribalancimi i zinxhirit ushqimor; ndryshimet klimatike; kujdesi ndaj mjedisit; biodiversiteti; punësimi dhe përfshirja e të rinjve; njohuria dhe inovacioni.

Nga **Z. Liam Breslin**, u përmendën edhe politikat në lidhje me pagesat direkte, përfshirë ato në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural si dhe organizimin e përbashkët të tregut, mbështetja për fermat organike,

Prezantimi u mbyll me hapat që vijnë më pas duke filluar nga viti 2018 deri në 2021.

Seancë e pyetjeve dhe përgjigjeve:

Z. Engjëll Skreli-Anëtar i KM –Pedagog në UBT:

Do të dëshironim që të kishim evidenca- tha ai në fjalën e tij, ose më saktë të mbaheshin të dhëna dhe në fund të mund të kryhet një vlerësim.

Z. Zigo Rutkovskis: Unë mendoj se Raporti i Qershorit 2020 do të mund të krijojë evidenca të mjaftueshme për një vlerësim të situatës- theksoi z. Rutkovskis.

Znj. Evelina Azizaj (ANRD): Në fjalën e saj, pasi ajo uroi suksese për projektin, ajo theksoi: Mund të them se përfundimet më të mira arrijnë sidomos pas konsultimeve me fermerët.

Ajo përmendi disa sfida që hasin fermerët sot, siç janë: problemi me **çertifikatat e pronësisë**, sidomos me ligjin 7501 datë 19.7.1991 “Për token” (Fletore zyrtare 5, viti 1991). Mungesa e këtyre certifikatave sjell probleme me fermerët dhe pengon (vështirëson) procesin e aplikimit. Sfida e dytë informimi paraprak, që fermerët të jenë sa më të informuar për ta ditur se cila thirrje u përshtatet më shumë për të aplikuar.

Sfida e tretë lidhet me projektin “100 fshatrat”. Duke u fokusuar më shumë tek pjesa turistike, bujqësia nuk përfiton sa duhet dhe kështu kjo krijon shpopullimin e këtyre fshatrave- përfundoi fjalën e saj zj. Evelina.

Z. Liam Breslin, duke falënderuar për këto komente shtoi edhe diçka në vazhdën e diskutimit të sfidave:

Së pari tha ai:- ka lidhje me thirrjen e dytë e cila duhet të hapet për Masat 1, 3 dhe 7. Gjithashtu deri në atë periudhë duhet të përfundojë paketa e Asistencës Teknike dhe t'i dërgohet Brukselit.

Së dyti vazhdoi ai:- duhet të mendoni edhe për Masat e tjera, siç është ajo e LEADER. Duhet të filloni përgatitjet që tani. Nëntori nuk duhet t'ju gjejë pa këtë paketë. Duhet të mendoni edhe për masat e tjera. Ndërsa në lidhje me reagimet apo sinjalet, pas një viti do bëjmë një vlerësim, që do jetë i nevojshëm për ne.

Z. Ilir Pilku: Në fjalën e tij ai theksoi se sa i përket përgatitjes së paketës së re për DG-AGRI në lidhje me aksesimin e komponentëve të IPA-s si për shembull: Masa LEADER mendoj se duhet të bëjmë miratimin e ligjshmërisë përkatëse për funksionimin e tij.

Akoma ligji mbi funksionimin e LAG-ve nuk është miratuar; duhet kordinimi dhe punë përgatitore me aktorët kryesorë, një nga të cilët është pushteti lokal. Po kështu duhet dhe një informim i hollësishëm në të gjithë territorin e vendit mbi funksionet dhe rolin e LAG-ve në politik-bërje.

Po kështu, ai vijoi fjalën e tij lidhur me mbështetjen e zonave të thella rurale me grante, mendoj se masat dhe kriteret në zonat e thella rurale duhet të rishikohen për t'u lehtësuar në mënyrë që të kemi një aksesim të fondeve të IPARD.

Kjo është e lidhur dhe me përfshirjen e të rinjve në aktivitetet bujqësore dhe rritjes së mundësisë së përfitimit nga grantet IPARD. Rezultatet pozitive të programit “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural në zonat e pafavorizuara të Shqipërisë” (SARED) dhe kriteret lehtësuese të tij mund të jenë një udhërefyes për këtë nismë- tha z. Pilku

Propozimet për rendin e ditës së takimit të ardhshëm mbi datën e re.

Z. Grigor Gjeçi u kërkoi pjesëmarrësve në takim, propozime për të organizuar takimin e ardhshëm të Komitetit të Monitorimit.

Zj. Frida Krifca propozoi që takimi i radhës të zhvillohet në muajt Nëntor ose Dhjetor, pasi duhet të fillojë dhe thirrja e dytë për aplikime dhe deri në kohën e takimit të KM, mund të ketë disa rezultate.

Z. Liam Breslin, shprehu se nëntori - dhjetori do të ishte më i përshtatshëm pasi mund të kishte një pasqyrë të qartë të thirrjes së dytë për aplikim.

Vendim Nr. 5

Takimi i pestë i Komitetit të Monitorimit të IPARD-it do të mbahet në nëntor- dhjetor 2019.

Mbyllja e takimit

III. Përmbledhje e konkluzioneve

Konkluzione	Komiteti Monitorues	Aktivitetet
Miratimi i Axfordës	Axforda u miratua me konsensus	
Miratimi i Minutave të takimit të tretë të KM	Minutat e takimit të tretë të KM u miratuan me konsensus	
Miratimi për ndryshimin e tretë të Programit IPARD II dhe modifikimin e dytë të Listës së Shpenzimeve të Pranueshme	Procedura e lançimit për modifikimin e tretë të Programit IPARD II.	Autoritetet kombëtare të IPARD duhet të vazhdojnë punën për modifikimin e tretë të Programit IPARD II dhe modifikimin e Listës së Shpenzimeve të Pranueshme.
Informacion mbi rezultatet e thirrjes së parë të IPARD	Thirrja e dytë për t'u nisur për tre masa - M1, M3 dhe M7.	Përgatitja për thirrjen e tretë për projekte për masat 1, 3 dhe 7.

FIRMA:


KRYETARI:

Z. BLENDAR ÇUÇI


Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

PËR SEKRETARIATIN E KOMITETIT MONITORUES

Përgatitur nga:


Zj. Anjeza Mezini Zj. Mimoza Maçi Zj. Edlira Linza

Aprovuar nga:


Z. Grigor Gjeçi- Drejtues i Autoritetit Menaxhues (AM)

ANEKS 1: Lista e pjesmarrësve

1. Anëtarët me të drejtë vote:

1. Bledar Çuçi, kryetar, MBZHR
2. Ermira Gjeçi, anëtar MBZHR
3. Enea Hoti, anëtar MBZHR
4. Lorena Pullumbi, anëtar MBZHR
5. Irfan Tarelli, anëtar MBZHR
6. Lauresha Grezda, anëtar MBZHR
7. Pjerin Shoshi, anëtar MBZHR
8. Elma Vathi, anëtar MBZHR
9. Klodiana Marika, anëtar MTM
10. Ergis Sefa, anëtar DZHM në Kryeministri
11. Alketa Knuti, anëtar MSHMS
12. Anxhela Bushati, anëtar MFE
13. Benjamin Bejko, anëtar MIE
14. Alban Çela, anëtar INSTAT
15. Pirro Anastasi, anëtar AKPT
16. Merita Uruçi, anëtar ADAMA
17. Enver Isufi, anëtar IBB
18. Agim Rrapaj anëtar KASH
19. Agim Sema, anëtar HABA
20. Silvana Subashi, anëtar AOA
21. Valbona Ylli, anëtar LEAA
22. Anila Vendresha, anëtar QUODEV
23. Engjell Skreli, anëtar, "ISETNJ"/UBT
24. Haxhi Bercaj, anëtar ZAGORA
25. Evelina Azizaj, anëtar IDM/ANRD
26. Tomi Pikuli, anëtar AGRINET
27. Bilal Sula, anëtar, Shkolla Mesme Kamëz
28. Tom Preku, anëtar, PFD
29. Matilda Naço, anëtar ATA

Nuk morën pjesë anëtarët e mëposhtëm me të drejtë vote:

1. Ermira Gjeçi, anëtar MBZHR
2. Lauresha Grezda, anëtar MBZHR
3. Klodiana Marika, anëtar MTM
4. Pirro Anastasi, anëtar AKPT
5. Anila Vendresha, anëtar QUODEV
6. Bilal Sula, anëtar, Shkolla Mesme Kamëz

2. Anëtarët pa të drejtë vote

1. Erjon Luçi, anëtar NAO
2. Sonila Hysi, anëtar NAO
3. Frida Krifca, anëtar AZHBR
4. Grigor Gjeçi, anëtar MA/MBZHR
5. Patris Hida, anëtar KKIPA/MEPJ

3. Përfaqësuesit e Komisionit Evropian

1. Liam Breslin, KE
2. Ziko Rutkovskis, KE
3. Razvan Ghittescu, Delegacioni BE

4. Vëzhguesit:

1. Manjola Vraja, AKU
2. Edlira Dibra, AKU
3. Anke Petersen, GIZ
4. Roland Çela, GIZ
5. Morten Sejersen, IPESA

5. Të ftuar të tjerë

1. Alketa Vejseli, ZKA/MF
2. Elona Musliu, FK/MF
3. Luena Ikonomi, FK/MF
4. Diana Voj, FK/MK
5. Julja Mata, AA
6. Marjeta Prendi, AA
7. Mirgen Dobruna, AZHBR
8. Eranda Mullaj, AZHBR
9. Xhoana Hudhra, MFE
10. Elvis Devole, MFE
11. Ermelinda Mulaj, MFE
12. Gramos Osmani, RISI Albania
13. Ilir Pilku, AASF/EBRD
14. Enida Shena, KASH
15. Mimoza Kalia, MSHMS
16. Elisa Teneqexhi, MBZHR
17. Michael Parker, FSAI
18. Lorena Totoni, ANRD
19. Alket Braho, MBZHR
20. Fatmir Nikolli, CBS

21. Teuta Topi, AM/MBZHR
22. Violeta Bakalli, AM/MBZHR
23. Anjeza Mezini, AM/MBZHR
24. Edlira Linza, AM/MBZHR
25. Mimoza Maçi AM/MBZHR
26. Melisa Cahani, AM/MBZHR
27. Sonila Najdeni, AM/MBZHR
28. Anisa Buneci, AM/MBZHR